

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies, organizatën LIBURNETIK dhe me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, organizuan aktivitetin me temë: "Fuqia e të Menduarit Kritik", drejtuar nga Prof.Asoc.Dr. Aida Goga.

Ky aktivitet ishte pjesë e projektit "UNI Debate" dhe kishte si qëllim fuqizimin e të rinjve duke i mbështetur ata me njohuri dhe aftësi që përforcojnë rolin e tyre në zhvillimin e një shoqërie më aktive dhe të ndërgjegjshme.

Objektivat e aktivitetit:

- Zhvillimi i mendimit kritik dhe qytetarisë aktive.
- Promovimi i aftësive të buta si komunikimi, lidhshipi dhe zgjidhja e konflikteve.
- Përgatitja e të rinjve për të kontribuar në sektorin e shoqërisë civile dhe tregun e punës.
- Rritjen e aftësive të mendimit kritik dhe angazhimin si qytetar të studentët.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit universitar për rëndësinë e debatit dhe pjesëmarrjes në proceset shoqërore.
- Përfshirja e të rinjve në platforma vendimmarrëse.

Në këtë aktivitet morën pjesë klubi i debatit, pedagogë dhe studentë të fakulteteve të ndryshme të universitetit, të cilët u përfshinë në organizimin e debatit sipas formatit Lincoln-Duglas.

